



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Universiteti "Haxhi Zeka"

Pejë, më 10.01.2025

Në bazë të nenit 14, të Rregullores për Veprimtarinë Kërkimore – Shkencore dhe Artistike ref. nr. 846/24, e dt. 29.03.2024, Universiteti "Haxhi Zeka" më datë 10.01.2025, shpall këtë:

Thirrje

PËR NDARJEN E ÇMIMIT VJETOR "PUNIMI MË I MIRË I VITIT" & "VEPRA ARTISTIKE MË E MIRË E VITIT" 2024

Universiteti "Haxhi Zeka", ka ndarë fondin për çmimin vjetor për rezultate të jashtëzakonshme kërkimore-shkencore dhe artistike brenda vitit kalendarik 2024. Nëpërmjet ndarjes së këtyre çmimeve synohet promovimi i cilësisë në punën shkencore, si dhe të inkurajohet ngritja në karrierë dhe shpërblimi i përpjekjeve dhe përkushtimi i hulumtuesve shkencorë apo veprimtarisë artistike.

Këtë vit do të ndahen 4 çmime për punimin më të mirë të vitit dhe 1 çmim për veprën artistike më të mirë të vitit në njësitë akademike si në vijim:

1. Fakulteti i Biznesit: 1 (një) çmim për punimin më të mirë të vitit,
2. Fakulteti Juridik: 1 (një) çmim për punimin më të mirë të vitit,
3. Fakulteti për Menaxhim në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis: 1 (një) çmim për punimin më të mirë të vitit,
4. Fakulteti i Agrobiznesit: 1 (një) çmim për punimin më të mirë të vitit;
5. Fakulteti i Arteve: 1 (një) çmim për veprën artistike më të mirë të vitit.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME TË APLIKIMIT

1. Punimet shkencore/veprat artistike duhet të jenë të realizuara dhe të publikuara brenda vitit 2024.
2. Punimet duhet të jenë të publikuara në njërën nga platformat si në vijim:
 - a) WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI, dhe AHCI);
 - b) SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4).
- 3) Vepra artistike duhet të jetë e përformuar ndërkombëtarisht.

3. Më rastin e aplikimit, mësimdhënësit/asistentët/korepetitorët duhet të dorëzojnë dokumentet e tyre në mënyrë elektronike, si dhe vegëzen për secilin aktivitet shkencor apo artistik, sipas pikës 1 të kësaj thirrje.
4. Të drejtë aplikimi kanë i gjithë stafi i rregullt akademik i UHZ-së.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES

1. Kriteret për çmimin "Hulumtuesi i vitit" janë:
 - a) Aplikuesi duhet të jetë autor i parë;
 - b) Punimi duhet të jetë i indeksuar në WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI, AHCI) dhe SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4);
 - c) Punimi duhet të jetë i publikuar në revistë që ka impakt faktor 2.0 e tutje;
 - d) Punimi duhet të jetë i publikuar në revistën kredibile;
 - e) Punimi duhet të ketë numrin më të lartë të citimeve;
 - f) Punimi duhet të jetë i fushës së aplikuesit;
 - g) Punimi duhet të ofroj njohuri të reja në shërbim të mësimnxënies për student;
 - h) Punimi duhet të ketë kontribut social;
 - i) Vepra artistike – Koncert solistik me vlera artistike;
 - j) Vepra artistike e realizuar në arenën ndërkombëtare.

III. SHPËRBLIMET

1. Grupi për Kërkime Shkencore është përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve, si dhe propozimin e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet e parapara.
2. Shpërblimi i mësimdhënësit/asistentit/korepetitorit bëhet në vlerë monetare prej 200 euro për secilin çmim nga njësitë përkatëse akademike, si dhe në vlerë jo-monetare ndarja e certifikatës.

Konkursi mbetet i hapur deri më 25.01.2025.

Dëshmitë e kërkuara sipas pikës 2 të kësaj thirrje duhet të dorëzohen në formë elektronike në postën elektronike: apliko.online@unhz.eu dhe pastaj në formë fizike në zyrën e protokollit në Rektorat nga ora 09:00 deri në orën 15:00. Dokumentet e dorëzuar pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Thirrjen mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare.